

## RREGULLORE

Nr. 1 /2016

### PËR NIVELET E LIÇENSIMIT TE TRANJEREVE TE BASKETBOLLIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit \_\_ , pika \_\_, të Statutit të Federatës Shqiptare të Basketbollit

#### FEDERATA SHQIPTARE E BASKETBOLLIT

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

#### Misioni i Federatës Shqiptare të Basketbollit

Basketbolli është e mirë publike dhe Federata Shqiptare e Basketbollit ka për mision:

a) tu krijojë mundësinë tranjerëve të basketbollit, të përfitojnë kualifikimin e vazhdueshëm dhe sistematik me anë të njohurive teorike dhe praktike;

b) të formojë tranjerë të kualifikuar, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së basketbollit në vendin tonë.

Neni 2

#### Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore ka për qëllim:

a) të përcaktojë nivelet e sistemit të liçensimit të tranjerëve të basketbollit në Republikën e Shqipërisë;

b) të krijojë një sistem të unifikuar të liçensimit të të gjithë tranjerëve të anëtarësuar pranë FSHB-së;

c) të garantojë mundësi të barabarta kualifikimi, mbi bazën e meritës, për të gjithë kandidatët që duan të liçensohen dhe të kualifikohen si trajnerë basketbolli pranë FSHB-së;

Neni 3

#### E drejta për liçensim

1. Të drejtën për të ndjekur nivelet e liçensimit e kanë të gjithë ata kandidatë që kanë përfunduar me sukses arsimin e lartë (ciklin e parë të studimeve bachelor; 180 kredite);

2. FSHB-ja garanton liçensimin edhe për kandidatët që plotësojnë kriterin e tre viteve si anëtar i FSHB-së në rolin e lojtarit të basketbollit (U16; U18; Kategoria I, Superiore);

3. Liçensimi u garantohet individëve që kanë mbushur moshën 18 vjeç.

Neni 4

#### Përkufizime

Në këtë rregullore emërtimet e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Liçensim” është procesi i pavarur për vlerësimin e nivelit të kualifikimit të trajnerëve, anëtarë të FSHB-së.

2. “SBK- Sistem Basketbolli Kreditimi” është përcaktimi i kreditit, sipas Federatës Shqiptare të Basketbollit.

3. “Monitorimi i trajnerëve” është procesi i ndjekjes së trajnerëve, lidhur me kualifikimet e tij të mëtejshme, sipas programit të kualifikimit të ndjekur organizuar nga FSHB-ja.

4. “Në liçensën “C” përfshihen trajnerët, të cilët kanë të drejtë të trajnojnë moshat nën 12 vjeç (përfshirë) si dhe kanë të drejtën e rolit të ndihmës trajnerit me grupmoshat nën 18 vjeç (përfshirë).

5. "Në liçensën "B" përfshihen trajnerët të cilët kanë të drejtë të trajnojnë moshat nën 18 vjeç (përfshirë) si dhe kanë të drejtën e rolit të ndihmës trajnerit në kategorinë e parë.

6. "Në liçensën "A" përfshihen trajnerët të cilët kanë të drejtë të trajnojnë në kategorinë e parë si dhe kanë të drejtën e rolit të ndihmës trajnerit në kategorinë superiore si dhe në ekipet kombëtare nën 20 vjeç (përfshirë).

7. "Në liçensën "Pro" përfshihen trajnerët të cilët kanë të drejtë të trajnojnë në kategorinë superiore dhe si dhe kanë të drejtën e trajnimit të ekipeve kombëtare.

8. "Sistemi i kreditimit" përfshin organizimin e kualifikimit të trajnerëve me grumbullimin e SBK-ve (1 SBK= 6 orë trajnim teorik/ praktik gjatë organizimit të kualifikimeve nga FSHB-ja; 1 SBK= 10 drejtime ndeshje si tranjer; 1 SBK= 20 drejtime ndeshje si ndihmës tranjer) .

9. "Tarifa e kreditit" është vlera monetare që paguan trajneri gjatë kualifikimeve për marrje të liçensës për 1 SBK (Liçensa "C" = 2000 leke të reja; Liçensa "B" = 3000 leke të reja; Liçensa "A" = 4000 leke të reja; Liçensa "Pro" = 5000 leke të reja).

10. 'Konvertimi SBK' është procesi i njohjes dhe standartizimit të SBK-ve për ato trajnime që janë kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. FSHB ruan të drejtën e këtij procesi.

## KREU II

### ORGANIZIMI I NIVELEVE TË LIÇENSIMIT TE TRANJEREVE

#### Neni 5

#### **Fitimi i niveleve të liçensimit**

1. Për fitimin e liçensës "C" mund të aplikojë kandidati i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe ka përfunduar me sukses arsimin e lartë (ciklin e parë të studimeve bachelor; 180 kredite); ose

plotësuar kriterin e tre viteve si anëtar i FSHB-së në rolin e lojtarit të basketbollit (U16; U18; Kategoria I, Superiore);

1.1. Kandidati për fitimin e të drejtës së liçensës "C" duhet të ketë grumbulluar 8 SBK në kualifikimet e organizuara nga FSHB (me vërtetimin përkatës).

1.2. Kandidati paraqet dosjen me vërtetimet përkatëse pranë FSHB-së, i cili merr vendimin përfundimtar për fitimin e liçensës "C". Liçensa lëshohet nga FSHB-ja dhe firmoset nga Presidenti.

2. Kandidati i cili ka përfunduar ciklin e parë të studimeve bachelor (180 ECTS) pranë Universitetit të Sporteve të Tiranës apo IAL ekuivalente me të, fiton të drejtën e marrjes së liçensës "C" duke paraqitur kërkesën pranë FSHB-së me vërtetimin përkatës të përfundimit të studimeve (e noterizuar).

3. Për aplikimin e marrjes së liçensës "B" mund të aplikojë kandidati i cili ka fituar liçensën "C";

3.1. Kandidati për fitimin e të drejtës së liçensës "B" duhet të ketë grumbulluar 14 SBK në kualifikimet e organizuara nga FSHB pas marrjes së liçensës "C".

3.2. Kandidati paraqet dosjen me vërtetimet përkatëse pranë FSHB-së, i cili merr vendimin përfundimtar për fitimin e liçensës "B". Liçensa lëshohet nga FSHB-ja dhe firmoset nga Presidenti.

4. Për aplikimin e marrjes së liçensës "A" mund të aplikojë kandidati i cili ka fituar liçensën "B";

4.1. Kandidati për fitimin e të drejtës së liçensës "A" duhet të ketë grumbulluar 18 SBK në kualifikimet e organizuara nga FSHB pas marrjes së liçensës "B".

4.2. Kandidati paraqet dosjen me vërtetimet përkatëse pranë FSHB-së, i cili merr vendimin përfundimtar për fitimin e liçensës "A". Liçensa lëshohet nga FSHB-ja dhe firmoset nga Presidenti.

4. Për aplikimin e marrjes së liçensës "Pro" mund të aplikojë kandidati i cili ka fituar liçensën "A";

4.1. Kandidati për fitimin e të drejtës së liçensës "Pro" duhet të ketë grumbulluar 14 SBK në kualifikimet e organizuara nga FSHB pas marrjes së liçensës "A".

4.2. Kandidati paraqet dosjen me vërtetimet përkatëse pranë FSHB-së, i cili merr vendimin përfundimtar për fitimin e liçensës "Pro". Liçensa lëshohet nga FSHB-ja dhe firmoset nga Presidenti.

4.3 Kandidati që ka fituar të drejtën e liçensës "Pro" duhet që çdo 5 vjet nga marrja e liçensës të grumbullojë 20 SBK. FSHB ruan të drejtën e rinovimit të liçensës "Pro"

Neni 6

### **Punësimi i tranjerëve**

1. Trajnerët të rregjistruar pranë FSHB-së mund të punësohen sipas liçensës përkatëse në nivele të ndryshme kategorie duke ju referuar Nenit 4 pika 4,5,6,7 të kësaj rregulloreje.

2. Të drejtën e dhënies së nivelit të liçensimit e ruan FSHB-ja dhe ruan të drejtën e penalizimit nëse nuk zbatohen me korrektësi dispozitat e kësaj rregulloreje.

### **KREU III**

#### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 7

1. Brenda 14 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, kandidatët që kanë mbushur moshën 35 vjeç (trajnerë aktual të rregjistruar pranë FSHB-së) bëhen subjekt i kriterëve të kësaj rregulloreje duke shfuqizuar nivelin aktual të liçensës.

2. Liçensat e lëshuara në Republikën e Shqipërisë nga FSHB, për trajnerët që kanë mbushur moshën 36 vjeç përpara

hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, janë ekuivalente me nivelin aktual të pozicionit në shoqatat përkatëse.

3. Të gjitha shoqatat, që janë të anëtarësuara pranë FSHB-së fillojnë zbatimin e kësaj rregulloreje nga data e hyrjes në fuqi.

PRESIDENTI

**Avni PONARI**

Miratuar në datën 22.09.2016

